

**KONCEPTI I VETËVENDOSJES SË KOMBEVE NË VEPRËN E
FEHMI AGANIT**

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

BESNIK MARKU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

STUDIME PASUNIVERSITARE - MASTER

PRISHTINË

2021

KONCEPTI I VETËVENDOSJES SË KOMBEVE NË VEPRËN E FEHMI AGANIT

Mentori: Prof. Dr. Agim Hyseni

Kandidati: Besnik Marku

Parimi i së drejtës për vetëvendosje të kombeve është një çështje kompleksiteti që nga paraqitja e tij deri në ditët e sotme. Duke parë rëndësinë e mendimit sociologjik të Fehmi Aganit kemi shpjeguar këtë çështje të paraqitur në veprën e tij në vëllimin e tretë “Demokracia, kombi dhe vetëvendosja”, duke marrë parasysh rastin e kombit shqiptar në raport me serbët dhe shtetin serb. Shqiptarët kërkojnë të drejtën e vetëvendosjes si e drejtë që i është mohuar historikisht, ndërsa serbët kanë qëllim të mbajnë Kosovën si pjesë integrale të tyre dhe t’ua mohojnë këtë të drejtë.

E drejta që kombet të vendosin për vetveten ka kaluar në disa etapa, që nga Paqja e Vestfalisë, më pas Revolucioni Amerikan dhe Revolucioni Francez, Kongresi i Vjenës, dhe Konferenca e Paqes në Paris në vitin 1919 ku u përdor për herë të parë koncepti i vetëvendosjes nga Woodrow Wilson, që përmes katërmëdhjetëpikëshit të tij ua mundësoi shqiptarëve kosovare të kenë të drejtën për vetëvendosje. Njëri prej intelektualëve, i cili përmes këtij parimi kërkonte të drejtat për shqiptarët e Kosovës të cilat i mohoheshin nga regjimi Jugosllave, ishte edhe Profesor Agani.

Fehmi Agani trajtoi rrethanat kronologjike që nga vitet e 60-ta deri në vitet e 90-ta, sfidat dhe sakrificat e shqiptarëve kosovare që të kenë të drejtën për vetëvendosje dhe të gëzojnë të drejtën e kombësisë së tyre. Punimi trajton me kujdes rrethanat e zhvilluara gjatë kësaj periudhe, si një ngjarje me një peshë mjaft të madhe në aspektin socio-historik për shqiptarët e Kosovës. Studimi i kësaj teme dhe figurës njohëse të Aganit si profesor, filozof, sociolog, politolog, publicist, akademik dhe si një prej figurave më kontributdhënëse në historinë e Kosovës për çështjet vendimmarrëse, por edhe të disa prej koncepteve të cilat në veprimtarinë e tij i ka shtjelluar profesor Agani, siç janë: demokracia, kombi, shoqëria civile dhe partitë politike janë të rëndësishme edhe për faktin se, me aq sa dimë, deri më tash nuk ka pasur ndonjë studim të plotë në Departamentin e Sociologjisë në lidhje me këto ide socio-politike të Fehmi Aganit.

Ky punim masteri përmban hyrjen, katër kapituj dhe konkluzionet

Në **hyrje** të këtij punimi kemi treguar për arsyet dhe motivet e zgjedhjes së kësaj teme, për rëndësinë shkencore dhe shoqërore mbi këtë temë, për burimet dhe literaturën që është përdorur si dhe synimet dhe pritshmëritë e këtij studimi të masterit.

Kapitulli I – Jeta dhe vepra e Fehmi Aganit: Në këtë kapitull kemi paraqitur funksionin njohës dhe përgjithësisht biografik për profesor Fehmi Aganin, që nga jeta e hershme deri në ngritjen intelektuale të tij, më pas veprimtarinë shkencore që ishte e frytshme veçmas viteve të gjashtëdhjeta deri në vitet e nëntëdhjeta, dhe kontributin e tij për Universitetin e Prishtinës që nga viti 1965 kur u pranua si ligjërues në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, pastaj pjesëmarrja në demonstratat e vitit 1968 kundër okupatorit serb, ku Agani së bashku me studentët kishin si qëllim të drejtat e barabarta të shqiptarëve në ish-RSFJ, dhe kontributin e tij për themelimin e degës së Filozofisë dhe Sociologjisë në Fakultetin Filozofik në Prishtinë gjatë vitit 1972/73 dhe të Institutit të Filozofisë-Sociologjisë në vitin 1977. Realizimi i këtij kapitulli është arritur përmes mbledhjes së informatave, si nga arkivat, dokumentarët e ndryshëm të personave që e njihnin figurën e Aganit dhe bashkëpunuan me të, përmes shkrimeve që trajtohen në vëllimet e tij, si dhe faqe të internetit që përmbajnë informacione dhe diskutime për të.

Kapitulli II - Mendimi socio-politik i Fehmi Aganit: Në këtë pjesë të punimit kemi analizuar disa nga konceptet e veprimtarisë së Fehmi Aganit, të cilat i përmbledh në tetë vëllimet e tij, duke filluar prej demokracisë, kombit, shoqërisë civile dhe partive politike, pra rrethanat socio-historike që i trajton Agani rreth këtyre koncepteve dhe ndërlidhjen e tyre me prizmin shqiptar.

Kapitulli III - Koncepti i vetëvendosjes së kombeve sipas Fehmi Aganit: Në këtë kapitull kemi trajtuar çështjet kryesore të këtij punimi, fillimisht duke sqaruar rrethanat që ndikuan në krijimin e të drejtës së kombeve për vetëvendosje, që nga Paqja e Vestfalisë, më pas Revolucioni Amerikan dhe Revolucioni Francez, pastaj kontributi i Kongresit të Vjenës dhe Konferencës së Paqes në Paris. Në këtë kontekst, pyetjet kryesore që shtrohen janë:

- Çka nënkuptohet me konceptin e vetëvendosjes së kombeve?
- Cili është raporti në mes të vetëvendosjes së kombeve dhe të drejtave të njeriut?
- Ku qëndron dallimi ndërmjet ideve të Wilsonit dhe Leninit mbi parimin e vetëvendosjes?

Më tutje, kapitulli i përfshinë pikëpamjet socio-historike të Fehmi Aganit në lidhje me të drejtën e kombeve për vetëvendosje nga prizmi shqiptar, pasi e sheh si të drejtë themelore kolektive dhe ndërlidhet me shqiptarët më shumë se me çdo popull tjetër në botë, siç thekson ai: “Shqiptarët nuk duhet të konsiderohen pakicë siç pretendon Serbia, këtë e argumenton fakti se historikisht, duke marrë parasysh qenien kombëtare të shqiptarëve, realitetin politik në ish-Jugosllavi dhe normën e synimet e bashkësisë ndërkombëtare, konkludohet se shqiptarëve në ish-Jugosllavi nuk mund t’u mohohet e drejta për vetëvendosje”. Brenda këtij kapitulli trajtohet Roli i Konferencës së Bujanit dhe kërkesat e shqiptarëve ku për herë të parë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore paraqitet kërkesa për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, përmes së cilës parashihej krijimi i të drejtës për vetëvendosje, më pas pseudoargumentimet e Serbisë ndaj Kosovës që si qëllim kishin mohimin e së drejtës për vetëvendosje ku Serbia e paraqet Kosovën si pjesë integrale të saj.

Ndërsa në fund të këtij kapitulli kemi trajtuar zgjidhjen e çështjes së Kosovës në bazë të parimit demokratik të vetëvendosjes dhe ndikimin e faktorit ndërkombëtar që ka qenë prezentë jo vetëm si mbikqyrës e ndërmjetës por edhe si garantues i marrëveshjeve të arritura e veçanërisht në Konferencën e Rambujesë deri te marrëveshja e Kumanovës, që arrihet çlirimi përfundimtar i shqiptarëve të Kosovës, dhe triumfon parimi i vetëvendosjes.

Kapitulli IV- *Teoritë mbi vetëvendosjen e kombeve në perspektivën krahasimtare:* Në këtë kapitull të fundit kemi bërë një analizë krahasimtare të ideve të Fehmi Aganit mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje me ato të autorëve të tjerë në lidhje me këtë çështje. Autorët të tjerë të cilët janë analizuar janë: Ukshin Hoti, Agim Hyseni dhe Esat Stavileci.

Pyetjet hulumtuese

- Cili është kontributi i Fehmi Aganit në fushën e mendimit socio-politik shqiptar?
- Çka nënkupton vetëvendosja e kombeve sipas Fehmi Aganit?
- Si qëndron çështja me të drejtën e vetëvendosjes te populli shqiptar?
- Cila është esenca e mendimit të Fehmi Aganit mbi konceptin e të drejtës së kombeve për vetëvendosjen, në krahasim me studiuesit e tjerë?

Metodologjia e punimit

Në temën me titull “Koncepti i vetëvendosjes së kombeve në veprën e Fehmi Aganit”, fillimisht kemi analizuar veprat e autorëve të ndryshëm nga lëmia e filozofisë, sociologjisë, shkencave politike, drejtësisë dhe historisë, që kanë shkruar për konceptin e vetëvendosjes së kombeve.

Për këtë studim është përdorur metoda e analizës krahasuese, me të cilën kemi krahasuar idetë e Fehmi Aganit me ato të autorëve të tjerë. Autorët të tjerë, idetë e të cilëve janë marrë si bazë për krahasim në këtë punim janë: Ukshin Hoti, Agim Hyseni dhe Esat Stavileci.

Pjesë e metodologjisë është edhe analiza e përmbajtjes me të cilën kemi analizuar intervistat e Fehmi Aganit dhënë mediumeve vendore dhe ndërkombëtare gjatë viteve të 90-ta, atëherë kur ishte aktiv në sferën politike.

Përveç këtyre më lart, kemi bërë edhe hulumtim në biblioteka për të analizuar dokumente, fotografi dhe video-materiale.